


Janneke Schotveld

Mbreti
këmbëbretkosë

dhe
përralla
të tjera



Letërsi e huaj për fëmijë
Janneke Schotveld
Mbreti këmbëbretkosë dhe përralla të tjera
DITURIA

Janneke Schotveld

Mbreti
këmbëbretkosë

dhe
përralla
të tjera



Përktheu: Albana Shala

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Janneke Schotveld
De kikkerbiljetjes van de koning en andere sprookjes

Redaktore: Adelina Gjinaj
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© 2018, Uitgeverij Unieboek | Het Spectrum bv. For the original edition.
Translated from the Dutch language
www.unieboekspectrum.nl
© 2021/2022, DITURIA Publishing House. For the Albanian edition
© Copyright për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.

Botuesi falënderon përzemërsisht mbështetjen e Dutch Foundation for Literature

Nederlands
letterenfonds
dutch foundation
for literature

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al
■ Shtëpia Botuese DITURIA

Përmbajtja

Mbreti këmbëbretkosë

Princeshë Ishana nga Përtejdetit

Jorisi dhe miza jetëshkurtër

Mbreti këmbëbretkosë



Ilustruar nga **Thé Tjong-Khing**

Njëherë e një kohë na ishte një mbret që i pëlqente shumë këmbët e bretkosave. Mbretëresha dyshonte se ai i pëlqente dhe i donte më shumë këmbët e bretkosave se atë. Shpesh ishte gati t'i thoshte: “Zgjidh e merr: o mua, o këmbët e bretkosave!” Por nuk e bënte, sepse ajo e donte të shoqin me gjithë marrëzitë e tij. Një ditë mbreti dhe mbretëresha u bënë me vajzë. Princeshën e vogël e quajtën Begonia, por që nga dita e parë mbreti vendosi ta thërriste “bretkosa ime e vogël e dashur”.

Begonia u rrit dhe u bë një vajzë e bukur, që nuk i ngjante aspak një bretkose. Edhe asaj i pëlqente të hante këmbë bretkosash.

- Pse hamë këmbë bretkosash vetëm të shtunave?- pyeti një herë Begonia.

- Sepse mamaja jote nuk na lejon që t'i gatuajmë më shpesh,- u përgjigj i ati.- Edhe sepse kështu mbetet diçka e veçantë, moj bretkosa ime e vogël.

Kishte të drejtë, sepse çdo të shtunë në kështjellë bëhej festë. Që herët në mëngjes, kuzhinierët fillonin të marinonin këmbët e bretkosave dhe, nga ora katër e pasdites, e gjithë kështjella mbushej me aromën e atyre që piqeshin. Begonia mezi i priste të shtunat.

Por jo mbretëresha. Shpesh ajo ankohej për festat e të shtunave. I vinte keq për bretkosat, por mbreti asnjëherë nuk ua vuri veshin fjalëve të saj.

- Nesër është ditë e shënuar, bretkosa ime e dashur,- tha mbreti pasi hëngri mëngjesin.

- Nesër mbush dhjetë vjeçe!- thirri Begonia e gëzuar.- A do të më bëni dhuratë këpucë të reja futbollit?

I ati buzëqeshi sikur po mbante një sekret.- Ndoshta. Por do të marrësh si dhuratë edhe diçka tjetër shumë të lezetshme.

- Çfarë?

- Bretkosa ime e dashur, nesër ti do të mund të shikosh bodrumin e bretkosave!- iu përgjigj i ati i lumtur. Ai kafshoi pak buzën dhe shtoi.- Eh, këtë doja ta mbaja sekret.

Begonia e përqafoi atin e saj.- Atëherë, a mundem të filloj që nesër të zgjedh edhe unë bretkosat që më pëlqejnë t'i ha, ashtu si ti?

- Po, më të mëdhatë janë për ty. Tani dil dhe luaj, bretkosa ime e ëmbël. Se nëna jote dhe unë duhet të drejtojmë vendin.- Ati e çoi drejt portës së kështjellës.

- Le të shpresojmë që ajo të jetë më e mençur se ti,- dëgjoi mbretëreshën tek ankohej.

- E dashur, të lutem, mos bëj kështu,- ia ktheu i ati, dhe Begonia nuk kuptoi se çfarë tha tjetër sepse ajo filloi të vraponte me topin e artë në lëndinë. Si një futbolliste e shquar ajo e goditi topin fort.

- Princesshë Begonia godet e bën gol me të parën,- bërtiti, duke imituar komentuesen e ndeshjes.- Çdo goditje e saj është gol, e pabesueshme!- shtoi.

Dhe filloi të vraponte shumë shpejt, sepse topi mund të binte në liqenin e vogël. Topi arriti buzë liqenit dhe aty ndaloi.

- Çfarë preçizioni, çfarë aftësie,- tha Begonia për veten e saj, ndërsa iu afrua topit me kureshtje. Papritur pati një ndjesi të çuditshme, se aty nuk ishte vetëm. Dhe ashtu ishte vërtet. Pas topit ishte një krijesë jeshile.

Begonia e mori shpejt topin dhe shkoi e u ul mbi të. Kafsha i kujtoi përrallat që i lexonin prindërit. Një nga historitë ishte me një zhabë, i cili u kthye në princ kur princesha e puthi. Kafshëza buzë pellgut i ngjante zhabës së librit me përralla.

- Ti je një zhabë?- pyeti ajo.

Kafsha kërceu përpjetë.- Një çfarë?

- Një zhabë? A të të puth?- Ose më mirë jo, sepse ende nuk dua të bie në dashuri.

- Budallaçkë vajzë. Jam bretk, jo zhabë.

- Bretk?

- Zhabat janë truptrasha, të ngathëta dhe lëkurën e kanë plot puçrra me helm. Bretkosat janë të holla dhe elegante. Ato kërcejnë si askush e notojnë si kampionë. Si të vërtetonte atë që tha, bretku kërceu gjithë hir.

- E more vesh?- tha bretku, kur më në fund e ndali vrullin.

Begonia e vështroi edhe një herë bretkun me kujdes. Ah, po, papritmas e kuptoi. Kur marinohen dhe piquen, këmbët e bretkosave, marrin një ngjyrë portokalli dhe bëhen krokante. Por tani e kuptoi se si kishin qenë më parë. Të

gjelbra, elastike, muskulore, ashtu të ngjitura me pjesën tjetër të trupit. Kishte uri. Dhe nuk kishte përse të kuptonte më shumë nga jeta e bretkosave.

U ngrit me vërtik, rrëmbeu topin dhe vrapoi drejt e në kështjellë.

- Babi, babi, është një bretkosë në kopsht dhe ajo tha që...

- Një bretkosë? Vërtet? Një bretkosë e freskët, e egër?- e ndërpreu mbreti. Begonia pohoi me kokë.

Mbreti doli me vrap në kopsht dhe prej andej pa bretkun e ulur buzë ujit. Kafsha nuk kishte lëvizur nga vendi.

- Një bretkosë e freskët, e egër,- përsëriti mbreti dhe lëpiu buzët.

- Babi?

Por i ati nuk e dëgjoi. Mbreti hyri si i hipnotizuar në kopsht, drejt e drejt bretkosës.

- Babi!- Begonia vrapoi pas tij.

Pastaj gjithçka ndodhi shumë shpejt. Bretkosa kërceu dhe nxori një gjuhë të gjatë rozë. Gjuha shkoi e iu ngjit mbretit, a thua se ai ishte një mizë. Mbreti u tremb dhe bëri nja dy hapa mbrapa, por bretkosa ishte shumë e shpejtë. Papritmas, mbreti u zhduk. *Puf!* si një fluskë e shpuar sapuni. Vetëm kurora dhe rrobat e tij ranë mbi bar. Bretku kërceu gjithë hijeshi në ujë dhe u zhduk.

Begonia mbeti e shtangur e pa fjalë. Vështroi grumbullin e rrobave me të cilat kishte qenë i veshur i ati. Në mëngën e kostumit mbretëror diçka lëvizi. Prej andej doli një bretkosë. “Kuak-kuak,” bënte bretkosa e dëshpëruar.

- Babi?- pyeti Begonia.

- Kuak,- tha bretku gjithë trishtim.

Begonia u përkul, hapi duart e bëra si fole dhe mbreti bretk kërceu brenda.

Asaj i erdhi pak ndot, sepse bretku ishte i pistë dhe i rrëshqitshëm.

- Ta marrë djalli! Çfarë po bën me atë bretkosë të ndyrë?- e pyeti mbretëresha, kur Begonia i tregoi të atin të shndërruar në bretk.

- Nuk është një bretk i ndyrë, është babi!- bërtiti Begonia.

Nëna e saj këqyri edhe një herë kafshën gjithë vëmendje.- Ah, tani po e shoh. E njëjta hundë e trashë,- tha. Bretku lëshoi një kuak i ofenduar.

- E po, këtë meritonte,- tha mbretëresha, duke tundur kokën.- Pritej që një ditë punët do të shkonin keq. S’kemi çfarë të bëjmë. Vetëm ta çojmë në bodrum me bretkosat e tjera.

Bretku bënte kuak-kuak sikur po protestonte. Mbretëresha u përkul derisa koka e saj ishte në të njëjtin nivel me bretkosën.- Si është puna? Nuk të pëlqen


që të rrih në bodrumin e bretkosave? Vetë thoshe se bretkosat atje ia kalonin shumë mirë. Prandaj nesër doje t'i tregoje edhe vajzës se nga vinin këmbët e bretkosave, apo jo? Nuk është problem që ta shohë një ditë më parë.

- A nuk do të ishte më mirë të kërkonim ndihmën e një magjistari?- pyeti Begonia.

- A njeh ti ndonjë magjistar?

Begonia hezitoi për pak.

- E sheh,- tha e ëma.- Eja, shkojmë.



Dhe kështu ndodhi që Begonia u fut në bodrumin e bretkosave të kështjellës me nënën e saj. Bodrumi ishte shumë i madh, i freskët dhe me mure të bardha. Në mure ishin gdhendur me mijëra fole, si edhe shumë kthina të rrethuara me hekura.

Në çdo fole, një bretkosë e ulur në një pellgaçe. Shumica e bretkosave nuk bënë zhurmë; disa lëshonin kuak-kuake të dëshpëruara. Mezi arrinin të lëviznin në qelinë e tyre. Dhe as nuk bëhej fjalë që të hidheshin e të kërcenin.

Begonia ishte frikësuar për vdekje e nuk bëzante. Gjithmonë kishte menduar se këmbët e bretkosave ishin ashtu të gatshme për t'u ngrënë. Si buka në kanistër. Sapo kishte kuptuar që këmbët e bretkosave u takonin bretkosave. Dhe ai bretku te liqeni kish kërcyer aq bukur dhe dukej aq i lumtur. Ndërsa në bodrum pa vetëm kafshë të vogla krejt të palumtura, që veç prisnin ditën kur do t'i çonin në kuzhinë. Nuk e kishte ditur. Ndjeu një lot që i rrodhi në faqe dhe ajo e lëpiu.

- E po tani, mos u bëj shumë sentimentale, bija ime. Ma jep mua babin.- Mbretëresha ia mori bretkosën nga dora dhe pa përreth.- Ah, ja ku paska një vend për ty atje.



Mbretëresha hapi një derë me hekura dhe e futi mbretin në një pellg të vogël me ujë. Në gjithë bodrumin jehoi rrapëllima e derës që u mbyll.

- Mami,- protestoi Begonia.

- Çfarë, bija ime? Babi tani është shndërruar në bretk. Dhe bretkosave u pëlqen të rrinë në kafaze, ku nuk mund të lëvizin fare, derisa të mbërrijë e shtuna dhe të vijnë t'i shpëtojnë e t'i hanë gjithë kënaqësi. Të paktën, kështu thoshte gjithmonë vetë babi, ti e mban mend, apo jo?

Begonia u skuq. Ishte e vërtetë, që i ati gjithmonë kështu thoshte.

- Mendoj se bretkosave u pëlqen më shumë të kërcejnë e të notojnë si kampionë të vërtetë,- mermëriti Begonia.

- Të drejtë ke, bija ime,- tha e ëma.- Por yt atë ka më shumë të drejtë, sepse ai asnjëherë nuk më dëgjonte kur unë i thosha të njëjtën gjë prej vitesh.

Begonia u ndie pak e turpëruar. E kishte dëgjuar të ëmën edhe më parë, por nuk e kishte kuptuar plotësisht. Apo nuk kishte dashur ta kuptonte? Se këmbët e bretkosave të fërguara ishin aq të shijshme!

- A nuk do të ishte më mirë ta fusnim në banjë lart, derisa të gjenim dikë që ta ndihmonte?- pyeti Begonia.

Ajo priti një përgjigje, duke mos humbur nga sytë kafazin ku kishin lënë të atin. Mes gjithë atyre mijëra bretkosave, me siguri që nuk do të arrinin ta dallonin.

- Sa zemër të mirë ke, bija ime,- i tha e ëma pas një heshtjeje të gjatë.- Më bëhet qejfi për këtë. Në rregull, le t'i japim pak kohë. Nesër është e shtunë. Nëse nuk gjejmë askënd për të na ndihmuar deri nesër, le ta çojmë në kuzhinë e ta hamë. Më mirë të mos vuajë sesa ta kalojë jetën si bretkosë.

Begonia nxitoi të shkonte e të hapte derën e qelisë ku ishte futur i ati. Ai i kërceu në duar dhe megjithëse ajo nuk donte t'i shikonte bretkosat e tjera, i pa.



Pas pak, mbreti bretk notoi i trishtuar në vaskë. Begonia e ushqeui me ca miza që i kishte marrë nga gropa e mizave në bodrum. Ai nxori gjuhën dhe i gëlltiti pa mundim.

- Begonia, eja të hash!- thirri mbretëresha.

Me zemër të thyer Begonia e la të atin në vaskë.- Do të kthehem sapa të mbaroj darkën.

I dëshpëruar mbreti fryu disa fluska në ujë.

E ëma ishte ulur në tavolinë, a thua se nuk kishte ndodhur asgjë e tmerrshme.- Nesër ke ditëlindjen, bijë e dashur. Po e pret me padurim?

- Sigurisht që nuk po e pres me padurim!- thirri Begonia.- Babi është kthyer në bretk, nuk do t'ia dish fare?

Nëna e saj buzëqeshi në mënyrë disi misterioze.- Jo, nuk dua t'ia di. Situata nuk është aq dramatike sa ç' duket. Bretku, që takove sot pasdite te liqeni, është shoku i një mikeshës sime.

- Kush ka shoqëri me një bretkosë?

- Ai nuk është gjithmonë bretk, ai është magjistar.
- Magjistar? Vërtet?- pyeti Begonia. Kurioziteti fitoi mbi ze-mërimin. Gjithmonë kishte dashur të takonte një magjistar, por në këto kohëra ishin të rrallë magjistarët.

- Thuajse magjistar, sepse është ende duke nxënë. Është një MNS.
- Çfarë do të thotë MNS?
- Magjistar-në-stërvitje. Kam shumë besim tek ai dhe, meqë nuk është diplomuar ende, nuk është i shtrenjtë. Po mendoj ta punësoj.

Edhe pse i ati ishte duke notuar lart në vaskë dhe ajo e dinte që nuk do të mund të fuste më në gojë këmbët e shijshme të bretkosave, Begonia u lumturua nga ky lajm. Një magjistar, ishte një mrekulli! Do t'i kërkonte që të bënte magji me këpucët e saj të futbollit, që t'ua kalonte të gjithëve kur të luante me top.

- Dhe ky MNS e ktheu babin në bretk, apo jo?
E ëma pohoi me kokë dhe me një vështrim triumfues...- Ai po diplomohet në ndryshimin e formave. Mendon se yt atë ka nxjerrë mësim deri tani?

- Besoj se po,- tha Begonia. Si edhe unë, shtoi me mend, por jo me zë të lartë.

Mbretëresha kërciti gishtat.- Ashraf!

Menjëherë në sallë hyri magjistari. Ai nuk ishte më shumë se një metër, ashtu siç janë magjistarët e tanishëm. Sepse kështu e kanë më të lehtë të zhduken sa herë që duan, pa u kuptuar. Por këtu Ashrafi ishte shumë i mirëpritur dhe Begonia e pëlqeu menjëherë. Jo vetëm që ishte i vogël, por ishte edhe shumë i ri në moshë. Ajo madje vuri re disa puçrra rreth hundës. Flokët i kishte blu dhe i shkonin shumë.

- Zonjë?- iu drejtua mbretëreshës magjistari.
- Mund të ma ktheni burrin tim,- tha mbretëresha.- Mendojmë që pësimi i është bërë mësim.
- Si të dëshironi,- u përgjigj magjistari, duke bërë një përkulje solemne dhe duke parë përreth.- Eh...
- E kemi futur në vaskë. Kati i dytë, dera e dytë në të djathtë.

Dhe pas pak dëgjuan mbretin tek shante e mallkonte me zë të lartë.

- Paska harruar t'i bënte një banjë përpara se ta kthente,- qeshi mbretëresha.
- Nuk mund të dal në shesh të burrave kështu!- dëgjuan mbretin që bërtiste.
- Më falni, një mijë herë ju kërkoj ndjesë,- dëgjuan tek thoshte magjistari.- Jam ende duke nxënë, në stërvitje, e shihni.

- Përsërite!- dëgjuan mbretin të thërrasë.- Dhe kësaj here bëje siç duhet, qurravec!

- Nuk mundem, ndryshimi i formës bëhet vetëm një herë. Më vjen shumë keq.

Tani mbretëresha u zbeh pak. Dhe Begonia filloi të shqetë-sohej.

Të dyja shikonin me ankth nga shkallët. Çfarë kishte shkuar keq? Fillimisht zbriti magjistari, me fytyrën të skuqur. Direkt pas tij vinte mbreti, duke u tundur pak.

Begonia nuk e pa menjëherë, por e ëma e kuptoi. Ajo duartrokiti tek u soll rreth e rrotull të shoqit. Pantallonat nuk i bënë më. Ishin tepër të ngushta, për kofshët dhe prapanicën e tij të zmadhuar.

Begonia e turpëruar shikonte të ëmën tek i prekte e fërkonte të pasmet e mbretit.- Çfarë kofshësh të bukura që ke, si këmbë bretkose!- tha ajo.

Mbreti ktheu kokën e u përpoq të shihte të pasmet e veta.- Vërtet, thua?

- Po, shumë më të lezetshme se ato të pasmet e sheshta si petull që më kishe më parë. Shumë, shumë më mirë...- Dhe përsëri ia përkëdheli të pasmet dhe kofshët.

Fytyra e mbretit u qetësua.- Oh, mirë atëherë. Nëse ty të duken ashtu.

- Je i punësuar,- i tha mbretëresha magjistarit.- Dhe ti, eja me mua lart!- e urdhëroi ajo mbretin.

Begonia nuk dinte ku të futej, kur mbeti vetëm me magjistarin në sallën e ngrënies.

- Ej... sa e bukur është ngjyra e flokëve të tu,- tha ajo.

Ashrafi preku me dorë flokët dhe iu përgjigj.- Faleminderit.

- A mund të bëni magji me këpucët e mia të futbollit, që t'ua kaloj të gjithëve?- e pyeti Begonia.

- Më mirë jo, le të shohim se çfarë mund të bësh vetë më parë!- tha Ashrafi dhe përplasi duart. Menjëherë një top u rrotullua te këmbët e tij.

- Përveç kësaj, ti më detyrohesh, se unë isha bretk e jo zhabë!- Ai e goditi topin dhe vrapoi jashtë i ndjekur nga Begonia.

- Gooooo!- u dëgjua nga kopshti i pallatit pak më vonë. Çuditërisht, Begonia nuk donte më të tregonte se kush shënoi.

Po bretkosat? Të gjitha u lanë të lira në liqenin e kështjellës. Ngrë-nia e këmbëve të bretkosave u ndalua në të gjithë mbretërinë dhe bretkosat u shpallën të shenjta. Thoni që nuk janë me fat. Këmbët e bretkosave të mbretit.

Princeshë Ishana nga Përtejdetit



Ilustruar nga Georgien Overwater

Na ishte njëherë një mbret dhe një mbretëreshë, të cilët donin me gjithë shpirt të liroheshin nga detyra e të dilnin në pension. Të qenit mbret dhe mbretëreshë është detyrë e rëndësishme dhe ata kishin mbretëruar me dëshirë, por tashmë donin të kishin më shumë kohë për t'u marrë me gjëra të tjera, personale.

- Vajzë e dashur, princesha jonë e bukur Lupinë, ka ardhur koha që të zgjedhësh një princ tani,- iu drejtua mbretëresha së bijës.

- Po, mama,- u përgjigj butësisht princesha Lupinë, sepse edhe ajo e dinte mirë se kishte ardhur koha. Por ajo nuk kishte takuar kurrë ndonjë princ tek i cili t'i mbetej mendja e për të cilin t'i rrihte zemra. Imagjino pastaj që të donte të martohej e të kalonte jetën me të.

- Bëhu gati, së shpejti do të kesh këtu shtatëqind princa të pashëm. Duhet të ketë një djalë të mirë mes tyre, apo jo?

- Shpresoj që po,- tha princesha dhe u nis për në dhomën e saj që të vishej me rrobat më të mira për këtë rast.



- Oh, sikur të vendosë sot,- i tha mbretëresha mbretit.
- Ah, sikur. Atëherë do të mund të dilnim në pension,- psherëtiu mbreti.
- Do të bënim shëtitje me biçikletë,- ëndërroi mbretëresha.
- Do të shkonim me pushime në vende të largëta, pa qenë nevoja të prisnim shirita nëpër ceremoni,- fantazoi i shoqi.
- Gjithë ditën e ditës do të mund të zgjidhja fjalëkryqe,- vazhdoi të ëndërronte mbretëresha.- Sa shumë më pëlqejnë. Më shumë se gjithçka.
- Thjesht, një xhiro me biçikletë,- shtoi mbreti.
- Të darkonim jashtë, pa salltanete, veshur thjeshtë.
- Do të mund të punoja vetë për qejf në kopsht.
- Do të lustroja me nge shpatën derisa të shkëlqente aq shumë sa të mund ta përdorja si një pasqyrë për të rruar mjekrën.
- Do të flinim deri vonë në mëngjes.
- Do të mund të rrija një javë të tërë pa u larë e pispillosur.
- Bah!- tha mbretëresha.- Kjo s'më pëlqen fare.
- Por mundet, kur të jemi në pension,- foli mbreti i kënaqur nga ky mendim. Në atë moment hyri një shërbëtor.- Kanë mbërritur të ftuarit. Shtatë autobusë, me nga njëqind princa të pashëm, nga të gjithë llojet e sojet.
- Rreshtojini në sallën e madhe, në rreshta me nga pesëdhjetë,- urdhëroi mbretëresha. E kuptoi që në zë që ishte pak e tensionuar.
- Eh...- Shërbëtori ngrii gishtin.
- Po, si është puna?- pyeti mbretëresha.


- Në fakt janë shtatëqind e një, një princ ka ardhur vetë. Duhet të them që ky është krejt vocërrak. A ta fus edhe atë në rresht?

- Sigurisht,- tha mbreti.

Shërbëtori nderoi dhe shkoi.

- Mos u bëj shumë kritike kësaj herë,- i tha mbreti vajzës kur u gjendën së bashku përpara derës së sallës ku ishin rreshtuar princat.

- Askush nuk është i përsosur.- Dhe ngurroi për një moment.- Përveç meje.- shtoi.



- Lëre-lëre,- tha mbretëresha.- Mbrëmë, kur po flije lëshove një pordhë aq të fortë, sikur po i bije një trumbete tunxhi.

Mbreti u bë flakë i kuq.- Vërtet?

- Sigurisht që po. Sa më zgjove nga gjumi.

Mbreti hapi pa një pa dy derën e sallës. Ja ku ishin shtatëqind e një princat e nderuar.

E nervozuar, princesha Lupinë vuri duart në kokë. Sot duhej të zgjidhte njërin. Mori frymë thellë dhe hyri brenda. Princat së bashku lëshuan një psherëtimë të thellë që i ngjau erës së butë të detit në një ditë vere. Ishte e bukur, princesha Lupinë. Kishte një lëkurë të mrekullueshme si zambak i bardhë dhe flokë të gjatë, të artë që i valëzoheshin mbi supe. Sytë e saj blu si deti i Mesdheut shndrisnin bukur tek vështronte princat një nga një. Një princ i pashëm u përkul hijshëm teksa Lupina i kaloi pranë.

- Jeni e mrekullueshme,- tha me një zë të bukur dhe të ngrohtë.

Princesha Lupinë ndjeu sesi e ëma dhe i ati mbajtën frymën. E vështroi princin. Ai kishte sy dhe flokë të bukur. Por ajo nuk ndjeu gjë dhe kështu vazhdoi të ecte më tej.

Kishte kaluar përpara shtatëdhjetë princërve. Dhe pyeste veten se si do të ndihej nëse do të shihte princin e duhur. Sikur një goditje rrufeje? Apo si një shkëndijë?

- Shikoje këtë,- i pëshpëriti mbreti. E tërhoqi princeshën nga fustani blu derisa ajo u detyrua të ndalonte. Princi në fjalë kishte një fytyrë të bukur, të zeshkët, që rrezatonte si dielli. Pa dyshim që do të kishin fëmijë të bukur.

- Princeshë,- iu drejtua ai me zë të ulët.- Do të doja t'ju njihja më mirë.- Ai kishte dhëmbë të bukur të bardhë si fildishi dhe dy gropëza të ëmbla në faqe.

- Zgjidh këtë,- i pëshpëriti e ëma.

Princesha Lupinë e këqyri nga afër princin. Në shikim të parë ishte vërtet shumë i pashëm dhe i ëmbël. Por ajo përsëri nuk ndjeu gjë dhe vazhdoi.



Princat u mërzitën nga pavendosmëria e princeshës. Po sikur edhe sot të mos zgjidhte asnjërin prej tyre? Donte apo nuk donte të sundonte dhe t'i shikonte prindërit të çliruar nga detyrimet. Ndoshta ajo do të ishte mbretëresha e parë beqare.

Pse jo? Shumë njerëz nuk martohen në kohërat e sotme. Ajo ishte aq e zhytur në mendime sa ndaloi për një çast përpara një princi shumë të vogël, me flokë të verdhë si kashtë. Si shpirt ky djalë, por më shumë si vëlla sesa si burrë.

- Ky?- pyetën të dy prindërit pak të habitur, por gjithë shpresë. Tashmë nuk u interesonte se cili, veç të arrinte të zgjidhte një.

- Vij nga larg, princeshë,- foli princi i vogël.

Ishte vërtet si një karamelle.

Pikërisht kur princesha ishte gati të thoshte: “Mirë, atëherë, le të jetë ky...”, ra dera.

- Tungjatjeta?- u dëgjua një zë.- Kam ardhur për princeshën Lupinë!

- A ta hap, madhëri?- pyeti një shërbëtor.

Mbreti dhe mbretëresha vështruan njëri-tjetrin. Ç'mund të presësh nga një princ që vjen me vonesë?

- Jo,- thanë ata.

- Po,- tha princesha Lupinë, sepse nuk i dihej.

Shërbëtori hezitoi për një çast, por duke qenë se së shpejti princesha do të bëhej mbretëreshë, ai vendosi t'i bindej paraprakisht.

Princesha Lupinë i hodhi edhe një vështrim princit të vogël. Edhe pse aq i ëmbël, ajo përsëri nuk ndjeu gjë dhe vazhdoi të ecte në sallën plot princër të dëshpëruar.

Ndërsa shërbëtori kishte zbritur poshtë për të hapur derën, ajo kishte parë edhe njëqind princa të tjerë. Kur ai u kthye, kishin mbetur vetëm dyqind princa.

- Ja edhe një princeshë, madhëri.

- Një princeshë?- pyetën mbreti dhe mbretëresha.

- Një princeshë?- tha princesha Lupinë.

Te dera qëndronte vërtet një princeshë. Një princeshë e bukur. Lëkura e saj ishte e errët dhe e lëmuar si çokolletë e zezë, sytë i kishte si bajame dhe kokën të rrethuar me një mijë gërsheta të zeza me shkëlqim. Kishte veshur një fustan të gjatë prej mëndafshi të artë si diell, i cili i rrinte shumë bukur. Edhe një herë princat lëshuan së bashku një psherëtimë si fllad deti.- Më falni që u vonova,- foli princesha.- Gabova në ndryshimin e orëve.

- Këta princa janë këtu për princeshën tonë,- i tha mbreti kur e mori veten nga habia.- A nuk mund të organizonin diçka të tillë prindërit tuaj? Pastaj nga vini, që paskemi kaq ndryshim orari?

Princesha qeshi. E qeshura tingëlloi si një mijë këmborë drenushash dhe ishte ngjitesë.

Princesha Lupinë qeshi me të.- Ati im, kanë mbetur edhe dyqind! Mua më duhet vetëm një. Pra, ka plot edhe për...- Ajo e pyeti vizitoren me vështrim.

- Quhem Ishana,- tha princesha.- Dhe vij nga Përtejdetit.

- Një princeshë nga Përtejdetit,- i murmuriti mbretëresha mbretit.- Nga një mbretëri e bukur dhe shumë e pasur.

- Mirë, mirë, por nuk ka ardhur një princ prej andej,- tha mbreti.- Përse ke ardhur princeshë Ishana e Përtejdetit?

- Kam ardhur për princeshën Lupinë.

Ra heshtja.

Princesha Lupinë ia nguli sytë princeshës me sytë si bajame. Princeshë Ishana u kthye dhe i buzëqeshi.- Kam dëgjuar shumë për ju,- tha ajo.

- Për mua?- tha princesha Lupinë e habitur dhe duke belbëzuar. Dhe mendoi: sa budallaqëqe që jam, s'po më vjen asgjë tjetër ndër mend për të thënë. Ndjeu që po i skuqeshin faqet.

Papritmas, edhe princeshë Ishana sikur u turpërua.- Po, për ty,- përsëriti ajo butë.

Dhe pastaj ndodhi. Një shkëndijë si argjend i bardhë u ndez. Më pas princesha Lupinë ndjeu një si flutur në bark, që iu përhap në gjithë trupin si fishekzjarr.

- Por çfarë kam dëgjuar nuk është e saktë,- vazhdoi princeshë Ishana.- Sepse në të vërtetë ju jeni edhe më e bukur.

Princesha Lupinë u mbështet për pak te një nga princat, i cili me dashamirësi i ofroi krahun.

- Prindërit e mi do të më sigurojnë një prikë të madhe dhe marrëdhënie shumë të mira midis dy mbretërive.- Princeshë Ishana bëri një përkulje të vogël të gjurit përpara mbretit dhe mbretëreshës.

Kur dëgjoi për prikën e madhe, mbreti filloi të buzëqeshte pak. Por vetëm për një moment.- Por ju jeni vajzë!- thirri ai.

- Po, jam.- Princeshë Ishana e shikoi me dashamirësi.

Ndërkohë, Princesha Lupinë e kishte marrë veten. Ajo iu afrua princeshë Ishanës dhe i qëndroi pranë. Sa erë të këndshme kishte!

- Babi, mami, këtë dua,- tha princesha.

- Po kjo është vajzë,- tha përsëri mbreti.

- Sapo e the këtë,- i fërshëlleu në vesh mbretëresha.

- Po nuk mundet, apo jo?- e pyeti mbreti të shoqen.

- Kush e ka thënë? Ku shkruhet?- ia ktheu mbretëresha.

- Askund, me sa di unë,- tha mbreti.

Princi i vogël me flokët si kashtë doli përpara.- A mund të them diçka?- pyeti. Pa prituri përgjigje, vazhdoi:- Në planetin tim, kushdo mund të martohet me kë të dojë. Ka vetëm një rregull...- Princi i vogël shikoi rreth dhomës me vëmendje.

- Thuaje,- e nxiti mbretëresha. Edhe pse ajo nuk besonte se ai ishte me të vërtetë nga një planet tjetër, dëshironte të dëgjonte atë që kishte për të thënë.

- Rregulli është: mund të martohen me kë të duan, për sa kohë që ata e duan vërtet njëri-tjetrin.- Princi i vogël përshëndeti dhe u kthye përsëri në rreshtin e princave.

Princesha Lupinë i buzëqeshi mikut të vogël. Për pak sa nuk kishte vendosur të martohej me të!

Mbreti buzëqeshi gjithashtu dhe shikoi vajzën e tij.

- E dashur bijë, a është vërtet ky princi me të cilin dëshiron të martohesh?

Mbretëresha e shtyu bashkëshortin e saj.- Princeshë. Është vajzë.



- Oh, po, bijë e dashur, a është vërtet kjo princesha me të cilën dëshiron të martohesh?

- Po, baba,- tha princesha Lupinë.- Kjo është.

Princat, duke e kuptuar se këto dy bukuroshe do t'u kalonin përpara hundës së tyre si të paarritshme, të emocionuar filluan të bisedonin me njëri-tjetrin. Disa madje ishin të zemëruar.

- Heshtje!- Mbretëresha rrahu shuplakat.

- Princesha Lupinë e ka gjetur princeshën e saj. Ju falënderojmë që keni ardhur dhe ju ftojme të gjithëve në dasmë.

Kjo sikur e rregulloi pak atmosferën, sepse në fund të fundit, dasmat janë gjithmonë argëtuese. Princat, me mirësjellje, i uruan çiftit të princeshave gjithë të mirat dhe u nisën të shkonin.

Princi i vogël ishte zhdukur papritmas dhe princeshë Lupinës i erdhi pak keq, sepse donte ta falënderonte për fjalët e mençura.

Pas dy javësh u bë dasma. Vendi që prej asaj dite u drejtua nga dy mbretëresha dhe populli krenohej me to.

- A di ndonjë fjalë tjetër për fjalën pordhë?- e pyeti ish-mbretëresha të shoqin, tek mbante stilolapsin e saj mbi një fjalëkryq.

- Jo,- u përgjigj ish-mbreti, tek rruhej duke përdorur shpatën e tij si pasqyrë.

- Si thua, shkojmë e bëjmë një xhiro me biçikletë?

Gruaja hodhi sytë jashtë.- Paska shumë erë.

- Do të të shtyj unë,- tha në mënyrë romantike i shoqi.

Ajo qeshi.- Mirë, mirë. Por, së pari, bëj një dush, se qelbesh erë.





Jorisi dhe miza jetëshkurtër



Ilustruar nga Peter-Paul Rauwerda

Një ditë prej ditësh, Jorisi nuk desh të ngrihej nga shtrati. Refuzoi. Çfarë nuk bënë e ëma dhe i ati, por djali nuk pranonte ta linte shtratin. Vetëm kur i duhej të shkonte në banjë, por për asgjë tjetër.

- Me siguri që do t'i kalojë kjo fazë e çuditshme,- tha i ati gjatë ditëve të para.

Por ditët u kthyen në javë e javët në muaj, dhe tani po bëhej viti që Jorisi nuk e linte shtratin.

Çfarë kishte ndodhur? Mackën e tij të dashur Pom e kishte shtypur makina tek ndiqte një flutur. Ja, në një moment ishte duke kërcyer dhe në një tjetër ishte shtrirë e pajetë në rrugë.

Edhe xha Beni, xhaxhai të cilin e donte aq shumë, u sëmur dhe vdiq. Tak-fak. Thonë se mund të kishte marrë ndonjë sëmundje gjatë udhëtimeve të shumta që bënte.

Dhe pastaj fatkeqësia e Jobit, atij fatkeqit, nga shkolla e tij. Në vendin e gabuar, në kohën e gabuar. Tek shpërndante gazetat i kishte rënë një piano mbi kokë. Pianon po e ngjisnin me litarë në katin e katërt, kur shkon e këputet kablloja dhe pianoja i bie Jobit.

Pas këtyre tri ngjarjeve, Jorisi vendosi të mos e linte krevatin. Prindërit iu lutën dhe iu lutën, por nuk arritën gjë. Ai ende nuk pranonte të lëvizte.

Në mëngjesin e ditës së njëqindtë, babai tha:- Tani boll më! Djali duhet të çohet nga shtrati.

- Po si se?- tha e ëma e shqetësuar.

- Të thërrasim të vijë mësuesja, të thërrasim edhe psikologun.

Psikologu gjithmonë mbante pak kohë të lirë për rastet urgjente, kështu që erdh menjëherë. Me kujdes, u ul në buzë të shtratis. Ishte një burrë i hollë me syze të trasha, përmes të cilave e zhburoi gjatë Jorisin.

- Si ndihesh?- e pyeti.

- Mirë,- tha Jorisi. Dhe ashtu ishte. Jorisi kishte një shtrat marinari të bukur dhe shumë kafshë-lodra pelushi me të cilat luante e vinte në jetë përrallat dhe

tregimet që lexonte. Ai nuk mërzitej kurrë.

Pas nja një ore, psikologu zbriti poshtë.- Një rast tipik i ankthit atipik të performancës në... Mund t'i jap disa ilaçe, Motorjo ose Dieseldril dhe pak Falderal që të mos fluturojë më shumë,- u tha prindërve të Jorisit.

- Ilaçe?!- thirri i ati.- Po ai është ende fëmijë! As që bëhet fjalë.

Dhe kështu psikologu u nis e shkoi dhe Jorisi vazhdoi të qëndrojë në shtrat.

- Kam dëgjuar diçka për një magjistar të vogël me flokë të purpurt,- mermëriti e menduar e ëma.

- Harroje!- thirri i ati.- Atyre nuk u zë besë.

- Një filozof atëherë?

Këtë po.

Doli që njëra jetonte aty afër dhe brenda një ore erdhi e ul buzë shtratit të Jorisit.

- Aty ku është vdekja nuk je ti dhe aty ku je ti, nuk është vdekja,- tha filozofja.

Jorisi ngriti sytë nga libri që po lexonte.

- Oh.

- Pra, më mirë të mos mendosh shumë për këtë, e kupton?

- Nuk po mendoj fare për çfarë më thoni, sepse jam duke lexuar.

- Por ti nuk ngrihesh nga shtrati sepse ke frikë nga vdekja,- këmbënguli filozofja.

- Për sa kohë që rri në shtrat nuk mund të më ndodhë asgjë dhe kështu nuk kam frikë,- tha Jorisi.

- Po kjo nuk është normale,- shtoi filozofja.

- Çfarë është normale?- pyeti Jorisi.

Pak e hutuar, filozofja zbriti shkallët.

- Hë, si shkoi?- e pyetën prindërit.

Por filozofja nuk u përgjigj dhe u nis të shkonte, ashtu e zhytur në mendime.

Dhe Jorisi vazhdoi të qëndronte në shtrat.

- Atëherë një mjek popullor?- tha i ati.- Njoh njërin që ka emër si i zoti.

I vetëquajturi mjek popullor, në fakt një sharlatan i vërtetë, kërkoi që të fliste në telefon me Jorisin.

- Alo?- tha Jorisi.

Pastaj dëgjoi dhe nuk foli për një kohë të gjatë. Pas një gjysmë ore ia dorëzoi telefonin mamasë së tij, e cila po priste aty pranë.

- Do të flasë me ju,- tha Jorisi.

Pas disa minutash, e ëma e mbylli telefonin e zhgënjyer.

- Çfarë tha?- pyeti i ati.

- Duhet të hajë çdo ditë bar, duhet t'i bëjmë masazh gishtit të madh të këmbës dhe...

- Lëre, mos vazhdo,- tha babai.

Më pas ishte koha e mësimit dhe erdhi mësuesja. Ajo vinte çdo ditë, që Jorisi të mos mbetet pas.

Kur mësuesja iku, erdhi një kloun që shkon e gëzon fëmijët e sëmurë, por Jorisi filloi të ankohej e të bërtiste aq fort sa klouni u zhduk nga sytë këmbët.

- Nuk më vjen ndër mend asgjë tjetër,- tha i ati.

- As mua,- tha e ëma...

- Le të shohim nesër. Ditë e re, shpresë e re,- vendosën së bashku prindërit.



Atë natë, Jorisi u zgjua nga një gudulisje në fytyrë. Me dorë fshiu hundën. Por pas pak, ndjeu përsëri një gudulisje. Ndezi abazhurin pranë shtratit, kur ç'të shikonte: sy më sy me një insekt. Një kafshëz truphollë, me dy krahë ovale pothuajse transparente dhe me dy antena në fund të trupit të saj, a thua se ishte veshur me frak.

- Përshëndetje!- tha insekti.

Jorisi mblodhi këmbët dhe e ngriti jorganin mbi hundë.- Po ti, çfarë je? Si hyre brenda?

Ai gjithmonë i mbyllte të gjitha dritaret, që të mos futeshin gazrat helmuese të ndonjë fabrike në afërsi, nëse fabrika do të shpërthente një ditë.

- Unë jam një mizë njëditëshe dhe, poshtë, njëra nga dritaret ishte e hapur.

- Do të më pickosh?- e pyeti Jorisi. Nuk e dinte nëse ishte alergjik ndaj pickimeve, por kishte dëgjuar se nga pickimet mund të fryheshe aq shumë sa të mbyteshe e të mos merrje më frymë.

- Edhe sikur të mundja, nuk do ta bëja,- tha miza njëditëshe.- Kështu jam unë.

Jorisi e këqyri me kujdes atë krijesë, që me të vërtetë, nuk dukej se kishte thumb. Në fakt ajo dukej e mirë dhe mjaft miqësore.

- Nga se ke frikë?- e pyeti miza njëditëshe.

- Nga asgjë,- tha Jorisi.

- Atëherë pse nuk jeton?

Jorisi u tremb. Nuk ishte gjallë? Kishte vdekur? Ashtu duhej të ishte, se kush fliste me një mizë? Ai pickoi fort krahun e tij:- Oh, jam gjallë!

- E po, kjo nuk më duket jetë,- tha miza njëditëshe.- Gjithë ditën në shtrat. Ndërsa unë do të dal të shoh lulet, të ngacmoj vajzat, të thith ajrin e pastër, të kërcej e të gëzoj sepse jeta është kaq e bukur.

- Por mund të të bjerë një piano në kokë se,- tha Jorisi.

- Edhe çfarë pastaj?- tha miza njëditëshe.

- Ose mund të sëmuresh për vdekje,- vazhdoi ai.

- Edhe çfarë pastaj?- tha miza njëditëshe.

- Ose mund t'ju shtypë një makinë,- vazhdoi Jorisi i patrazuar.

- Dhe, çfarë pastaj?- iu përgjigj miza njëditëshe.

- Atëherë më mirë rri brenda!- thirri.- Në vend që të sillesh e të sorollatesh.

- Pse?- e pyeti miza.

- E po, sepse...- Jorisi heshti.- E po, sepse...- mendoi ai.- Atëherë të gjitha këto nuk do të ndodhin.

- Atëherë mund të kem vdekur se,- tha miza njëditore.- Jo, unë do të gëzohem e do të kërcej.

Jorisi pyeti me dyshim:- A mund të kërcesh?

Miza rrotulloi sytë. Mbështolli krahët mjeshtërisht përgjatë trupit, drejtoi kurrizin dhe më pas kërcëu përpara dhe mbrapa nëpër jorgan.

Jorisi shpërtheu në gaz, sepse miza dukej shumë qesharake.

- Pse u fute këtu brenda?- e pyeti kur miza pushoi së kërcyeri.

- Kot, pa arsye,- tha miza.- Rastësisht fluturova e u futa brenda nga dritarja poshtë dhe thashë të shoh nëse ka ndonjë gjë argëtuese këtu. Por nuk paska. Mund ta hapësh dritaren që të dal jashtë? Përndryshe më duhet të zbres përsëri deri në katin e parë, ndërkohë që unë e kam jetën aq të shkurtër, sa mendoje vetë se ç'humbje kohe do të ishte.

Jorisi hapi pak dritaren. Dhe menjëherë në dhomë hyri fladi i ëmbël i verës. Kishte shumë kohë që nuk e shijonte më ajrin e natës. Miza njëditëshe fluturoi jashtë dhe thirri:- Mirupafshim!

- Mirupafshim,- ia ktheu Jorisi.- Prit!- thirri prapë. Miza u kthye dhe shikoi.

- Vërtet jeton vetëm një ditë?- e pyeti Jorisi.

Miza njëditëshe pohoi me kokë.- Po, në fakt vetëm një natë. Deri në mëngjes, më pas nuk do të jem më.

- Nuk ke frikë nga kjo?

- Frikë? Jo, sigurisht që jo. Kjo është jeta e një mize njëditëshe. Gëzohu dhe pastaj vdis. Kaq. Nuk mund të humbas kohë duke shpresuar të mos ishte kështu. Edhe pse do të doja të jetoja edhe një natë më shumë, edhe një tjetër, edhe një tjetër. A do të më falësh tani? Sepse kam parë ca vajza shumë të bukura që po fluturojnë rreth atij pellgut atje.

Jorisi pa pellgun në mes të kopshtit. Më parë ai peshkonte atje larva bretkosash dhe një herë kishte rënë brenda gjatë një loje "ta lashë". Dukej sikur kishin kaluar shekuj që nga ajo kohë e lumtur.

- Po, mirë, ia kalofsh bukur,- pëshpëriti Jorisi i menduar. Miza ishte zhdukur.

Papritur Jorisi u ndie shumë i lodhur. As nuk arriti të mbyllte si duhet dritaren. Dhe, ndërsa aromat e verës ia ngacmonin flegrat e hundës, e zuri përsëri gjumi.



- Ta marrë e mira, paska ngordhur një mizë në jastëk,- tha i ati kur i solli mëngjesin.

Jorisi u ngrit me vërtik. Një mizë e ngordhur?

- Po, por nuk të ka bërë gjë, bir. Do ta hedh tani.- Dhe e mori mizën në dorë.

- Jo!- bërtiti Jorisi.- Ma jep mua.

Pak i habitur, i ati ia vuri mizën në dorë.

- Ah,- tha Jorisi. Dhe lotët i shkuan çurg faqeve.

- Mizë është,- tha babai i tij i shqetësuar.- S'ka problem.

- Jo, nuk ka problem. Ajo është kënaqur gjithë natën.- tha Jorisi.- Duke luajtur me shoqet.- Dhe ashtu, duke lotuar, i buzë-qeshi mizës së ngordhur.

- Ndoshta duhet të fillojmë ato ilaçet që rekomandoi psikologu,- mërmëriti i ati me vete.

- Eja, do ta hedh. Ha mëngjesin, se pas pak do të vijë këtu mësuesja.

Babai i zgjati dorën që të merrte mizën. Por Jorisi e mbajti grushtin e mbyllur në kraharor.- Do ta varros, pranë pellgut,- tha ai.

U ngrit nga shtrati, zbriti shkallët, dhe u nis drejt kopshtit këmbëzbathur. Aty hapi një gropë të vogël dhe e futi mizën.

- Pusho në paqe, mikja ime,- tha. E ndjeu që ndoshta duhej të vajtonte, por në fakt nuk i vinte hiç për të qarë. Donte të kërcente. Prandaj shpejt e shpejt e

mbylli gropën dhe filloi të kërcente rreth pellgut, një herë, dy herë, tri herë, katër...

Prindërit kishin mbetur pa fjalë. Dhe mësuesja, që sapo kishte mbërritur me makinën e saj të vogël, u shtang dhe filloi t'i binte borisë e tronditur.

- Kthehu në shtëpi, mësuese!- Jorisi iu afrua.- Sepse që tani e tutje do të vij në shkollë.

- Me pizhame?- e pyeti mësuesja.

Jorisi qeshi.- Jo, mësuese. Pse, budalla jam unë? Po shkoj të vishem.- Dhe ashtu bëri.

- Nuk duhet të të çojmë në shkollë me makinë?- e pyetën prindërit.

- Nuk ka nevojë. Është vetëm dhjetë minuta në këmbë,- tha Jorisi.

- Por në rrugë ka shumë trafik,- tha e ëma.

- Dhe disa njerëz i ngasin makinat si të çmendur,- shtoi i ati.

Jorisi vështroi prindërit.- Mos u shqetësoni.- I puthi dhe filloi të vraponte.

Që nga ajo ditë, Jorisi jeton i gëzuar dhe pa andralla. Është rrëzuar, ka vrapuar, ka rënë nga pemët dhe në kanale, ka puthur vajza dhe djem dhe ka bërë mjaft gjëra të cilat është më mirë që prindërit të mos i dinë.

Dhe prindërit? Menduan se ky ishte ekstremi tjetër. Por prindërit si prindërit gjithmonë gjejnë diçka për t'u ankuar.





